

Analizë e Hapjes së Kuvendit në Kosovë

DHJETOR
2020



BOOST GOOD
GOVERNANCE

Analizë e Hapjes së Kuvendit në Kosovë

AUTORËT:

Dafina Olluri dhe Paulina Behluli

Dhjetor 2020

Hyrje

Duke shfrytëzuar përvojën e kaluar me partnerët nga rrjeti rajonal i OJQ-ve "Action SEE", Open Data Kosova ka përgatitur dokumentin e propozimit të politikave në të cilin analizon nivelin e transparencës, hapjes institucionale, hapjes dhe përgjegjësisë së Kuvendit në Kosovë për vitin 2019.

Analiza e propozimit të politikave praktike është rezultat i një hulumtimi të gjerë të bazuar në metodologjinë shkencore të kryer nga Open Data Kosova në muajtë e fundit. Qëllimi i këtij hulumtimi gjithpërfshirës është të sigurojë një pasqyrë të detajuar të situatës në Kosovë dhe të kontribuojë në zbatimin e reformës së administratës publik. Ky punim gjithashtu synon të forcojë parimet e qeverisjes së mirë dhe të ndihmojë institucionet t'i zbatojnë ato në mënyrë më efektive në punën e tyre.

Pas një vlerësimi të qëllimit të propozuar në vitet e kaluara, të bërë për tre vjet rresht nga 2016 në 2018, ky punim paraqet analizën e nivelit të hapjes dhe rekomandimet për përmirësim për vitin 2019. Metodologjia dhe treguesit e saj janë përmirësuar vazhdimisht dhe i janë përshtatur kërkesave të vitit përkatës. Ky dokument i politikave sjell gjithashtu një element krahasues ku ODK-ja ka hartuar një analizë të përmirësimit përgjatë viteve kur matja është kryer.

Hapja institucionale duhet të jetë politika e të gjitha qeverive në rajon dhe duhet të formulohet dhe trajtohet në mënyrë të barabartë si politikat e tjera të rëndësishme. Një politikë e tillë duhet të ruajë objektivitetin e saj në këtë çështje dhe nuk duhet të ndikohet në asnjë rast nga vendimet aktuale politike ose elemente tjera politike. Ky dokument i propozimit të politikave i drejtohet parlamentit dhe vendimmarrësve të cilët mund të përfitojnë nga ky dokument nëse rezultatet dhe rekomandimet e tij merren parasysh me kujdes. Dokumenti mund të jetë i dobishëm edhe për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe kolegëve nga sektori i OJQ-ve që merren me këto çështje.

ODK-ja ka respektuar parimet e transparencës së hulumtimit dhe ka prezantuar tek institucionet të gjitha detajet dhe rezultatet e tij. ODK-ja mbetet e hapur për çdo sugjerim, kritikë konstruktive dhe diskutim në lidhje me dokumentin e politikave.

Metodologjia e hulumtimit

Të qenit të hapur paraqet njërin ndër kushtet kryesore për demokracinë pasi i lejon qytetarët të marrin informacionin e nevojshëm për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efikase dhe llogaridhënie të institucioneve për politikën e tyre. Institucionet në të gjithë botën ndërmarrin aktivitete specifike me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së tyre ndaj qytetarëve. Indeksi rajonal i hapjes së Kuvendit është krijuar në mënyrë që të përcaktohet shkalla e marrjes së informacioneve të arritshme dhe të kuptueshme nga institucionet publike.

Indeksi rajonal i hapjes mat se deri në çfarë mase janë institucionet e vendeve të Ballkanit Perëndimor të hapura për qytetarët dhe shoqërinë dhe bazohet në katër parimet e mëposhtme: 1) transparencë, 2) qasshmëria, 3) integriteti dhe 4) ndërgjegjësimi. Parimi i transparencës kërkon që informacioni organizativ, buxheti dhe procedura e prokurimeve publike të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikohen dhe përditësohen rregullisht. Mundësia e qasjes lidhet me sigurimin dhe respektimin e procedurave për një qasje të lirë në informacion, përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit përmes debateve publike dhe forcimin e ndërvëprimit me qytetarët. Integriteti përfshin elementet e parandalimit të korrupsionit, kryerjen e kodit të etikës dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, ndërgjegjësimi, i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të kryera nga institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime zhvillohen më tej përmes treguesve specifik, sasiorë dhe cilësorë. Parimet e tilla vlerësohen në bazë të: qasjes së informacionit në faqet zyrtare të institucioneve, cilësisë së kornizës ligjore për pyetje specifike, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione. Mbledhja e të dhënave ndoqi një model verifikimi të të dhënave i cili rezultoi në gabimin standard prej +/- 3%. Matja u krye në periudhën nga muaji maj 2020 deri në fund të muajit dhjetor 2020. Një grup rekomandimesh drejtuar institucioneve u zhvillua në bazë të rezultateve të hulumtimit.

Hapja e Kuvendit në vitin 2016

Kuvendi i Kosovës shënoi rezultat prej 60% në treguesit e hapjes. Ky rezultat është disi i kënaqshëm, duke treguar disa përpjekje të qarta për të rritur hapjen e kuvendit. Megjithatë, kishte hapësirë për përmirësim. Kuvendii i Kosovës shënoi 47.73% në aspektin e Qasshmërisë, dhe 50% kur ishte fjala për aspektin e Efektivitetit, i cili lidhet me planifikimin strategjik dhe monitorimin parlamentar si mjet të hapjes. Kosova ka shënuar rezultate të larta në përbërësin e komponentin e integritetit me një rezultat të përgjithshëm prej 83% dhe ka shënuar 60% në aspektin e transparencës.

Hapja e Kuvendit në vitin 2017

Parlamenti i Kosovës shënoi 49% duke u bazuar në treguesit e hapjes. Ky rezultat nuk u vlerësua si i kënaqshëm, duke marrë parasysh që në matjen e fundit Kosova u rendit e dyta në rajon duke shënuar 60% të indikatorëve. Kjo tregoi se nuk kishte pasur ndonjë rritje në përpjekjet për hapjen parlamentare, prandaj vendi kishte një rënie prej tre vendeve më poshtë. Gjatë matjes së këtij viti, Kosova shënoi 45% në aspektin e qasjes, 16% në aspektin e ndërgjegjësimit, 69% në lidhje me komponentin e integritetit dhe 48% sa i përket transparencës.

Hapja e Kuvendit në vitin 2018

Kuvendi i Kosovës shënoi gjithsej 73%. Renditja e Kosovës në vitin përkatës ishte më e kënaqshme se ajo e një viti më parë, duke shfaqur një rritje të përpjekjeve për Hapjen e Kuvendit me shumë mjete dhe mekanizma të krijuar si Forumi i Transparencës, zyra për bashkëpunim me shoqërinë civile, hapja e takimeve të komisionit, etj. Sidoqoftë, kishte ende hapësirë për përmirësim. Gjithashtu, duhet të theksohet se hulumtimi është bërë më shumë për parlamentin si institucion dhe politikat ekzistuese sesa si një analizë e punës së deputetëve. Kuvendi i Kosovës shënoi 55% në parimin e qasshmërisë, 80% në komponentën e ndërgjegjësimit, 82% në parimin e integritetit dhe 78% në parimin e transparencës.

Hapja e Kuvendit në vitin 2019

Kuvendi i i Kosovës shënoi një rezultat të përgjithshëm prej 80,5% në aspektin e hapjes për vitin 2019. Një rezultat i tillë tregon një përmirësim të madh të këtij institucioni përgjatë viteve. Meqenëse ka gjithnjë hapësirë për përmirësim, ky rezultat tregon se Kuvendi ka rritur hapjen e tij me kalimin e viteve. Kur u mat për herë të parë në vitin 2016, Kuvendi i Kosovës shënoi 60% në tregues, ndërsa tani rezultati tregon përmirësim për shkak të përpjekjeve të bëra ndër vite. Nëse do të krahasonim një rezultat të tillë në një kontekst rajonal, Kuvendi i Kosovës ka shumë për të bërë në aspektin e hapjes së tij, megjithatë, në kontekstin kombëtar një përmirësim i tillë është i kënaqshëm. Rezultatet e indeksit u arritën duke marrë parasysh katër Parimet për Hapjen e Kuvendit të cilat përfshijnë: transparencën, qasshmërinë, integritetin dhe ndërgjegjësimin. Në pjesën vijuese, do të ketë një shpjegim të hollësishëm të parimeve kryesore dhe rezultatit të Kuvendit në fushat e lartpërmendura.

QASSHMËRIA (68%)

Qasshmëria adreson nivelin e qytetarëve, OSHC-ve, akterëve të interesuar për të marrë pjesë në punën e Kuvendit, duke përfshirë por pa u kufizuar në Aktin e Lirisë së Informacionit dhe rregulloreve të tjera. Në këtë aspekt, Kuvendi i Kosovës shënoi 68% sa i përket parimit të Qasshmërisë, i cili është 13% më i lartë se një vit më parë. Sa i përket komunikimit me publikun, nuk ekzistojnë kanale të komunikimit direkt të cilat siguronin qasje në komunikim të drejtpërdrejtë midis publikut të gjerë dhe parlamentit; megjithatë, ODK në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës po zhvillojnë zgjidhjen digjitale, E-pjesëmarrjen e cila do të fillojë funksionimin në muajin shkurt të vitit 2021.

Një zgjidhje e tillë; një platformë e konsultimit publik mundëson komunikim të drejtpërdrejtë mes publikut të gjerë dhe deputetëve. Në teori, konsultimi publik ofron një mundësi për interesat e një grupi më divers të publikut që të kenë qasje në pushtetin politik dhe të marrin pjesë në ushtrimin e tij. Përveç platformës së konsultimit publik që do të zhvillohet, Kuvendii i Kosovës është gjithashtu i qasshëm përmes kanaleve të mediave sociale si Facebook¹ i cili mundëson që veprimtaritë e Kuvendit të komunikohen në mënyrë efektive tek audienca më e re. Kuvendi i Kosovës duhet të zhvillojë më shumë trajnime për stafin në fushën e qasjes në informata publike. Sipas sondazhit të plotësuar nga përfaqësuesit e Kuvendin të Kosovës, stafi i Kuvendit të Kosovës ka marrë pjesë në disa sesione trajnuese të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike mbi temat e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumentet publike në vitin 2018 dhe 2019. Sesionet dhe punëtoritë e tilla trajnuese zakonisht organizohen nga organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë/institucionet e tjera të cilat nga ana tjetër ndihmojnë zyrtarët publik të Kosovës të trajtojnë kërkesat për qasje në dokumentet publike. Edhe pse nuk ka asnjë detyrim ligjor që stafi i Parlamentit të Kosovës të zhvillojë seanca trajnime ose punëtori, zyrtarët megjithatë po përfitojnë nga mundësi të tilla për ngritjen e kapaciteteve duke marrë pjesë në to.

¹ <https://www.facebook.com/kuvendi.skupstina>

Kosova është vlerësuar lartë në vlerësimin e Indeksit të Qasjes për shkak të infrastrukturës së saj të mirë për lirinë e informacionit, siç parashikohet në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike i cili është rishikuar me sukses në muajin korrik të vitit 2019. Sipas këtij ligji, institucioni ka një person të caktuar i cili merret me kërkesat e Lirisë së Informacionit (LF) e i cili kalon një kohë minimale të arsyeshme duke iu përgjigjur kërkesave. Përveç kësaj, Ligji gjithashtu ka prezantuar Komisionarin për Informim dhe Privatësi i cili do të përmbledhë zbatimin e ligjit dhe do të sigurojë që kërkesat të trajtohen në mënyrë të duhur. Sidoqoftë, në këtë rast specifik përfshihet dallimi (dikotomia) në procesin e zbatimit praktik të një ligji të tillë. Siç u diskutua gjithashtu me stafin e brendshëm të Agjencisë së Informacionit dhe Privatësisë, Komisionari për Informim dhe Privatësi ende nuk është zgjedhur nga Kuvendii i Kosovës. Që nga themelimi ligjor i Agjencisë së Informacionit dhe Privatësisë, Agjencisë i mungon Komisionari për Informim dhe Privatësi, dhe pozita aktuale më e lartë është ajo e drejtorit ekzekutiv.

E drejta për t'u qasur në informata nuk vlen për ndërmarrjet shtetërore, ndërmarrjet publike, ose subjektet e tjera që kontrollohen nga Kuvendi, gjë e cila konsiderohet si një problem i vazhdueshëm nga matja e fundit. Një aspekt tjetër që është duke parandaluar zbatimin e duhur të këtij ligji është dështimi për të publikuar një listë të regjistrave dhe dokumenteve në posedim të tij, ashtu siç kërkohet ligjërisht.

Sa i përket veçorisë së butonit të shiritit të kërkimit, ka pasur përmirësime në faqen zyrtare të Kuvendit, një tipar i cili tani funksionon dhe e bën më të lehtë për qytetarët të navigojnë dhe të kontrollojnë dokumentet ose raportet në platformë.

Peticionet elektronike janë një fushë premtuese për sa i përket hapjes institucionale, pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar. Një fushë e tillë është thelbësore për rritjen e rolit të hapjes brenda parlamentit dhe përket në komponentin e qasjes. Deri sot, nuk ka asnjë mekanizëm të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në lidhje me sistemin e peticionit elektronik. Kjo është arsyeja pse, në tre treguesit që lidhen me peticionin elektronik, Kosova ka shënuar zero pikë. Meqenëse kjo formë e angazhimit të qytetarëve në punën e njësive të administratës publike inkurajohet dhe miratohet nga shumë rrjete ndërkombëtare d.m.th. Partneriteti për Qeveri të Hapur², ne rekomandojmë që Kuvendi i Kosovës të lëvizë drejt sistemeve të tilla; në ato më transparente dhe më të qasshme sesa peticionet tradicionale.

2 <https://www.opengovpartnership.org/policy-area/e-petitions/>

Marrëdhënia e mirë me shoqërinë civile, duke përfshirë shoqërinë civile në procesin e zbatimit të ligjeve është një element thelbësor drejt një qeverie të hapur dhe të përgjegjshme. Në këtë aspekt, Kuvendi i Kosovës mban një marrëdhënie të mirë me shoqërinë civile siç parashikohet edhe nga rregulloret e punës në komisionet parlamentare (Rregullorja e Punës, neni 65). Përveç kësaj, është një person i caktuar përgjegjës për mirëmbajtjen e marrëdhënies dhe komunikimin e rregullt me OSHC-të dhe përcjelljes e platformës së regjistrimit në internet për palët e interesuara. Një arritje tjetër e Kuvendi të Kosovës është krijimi i grupit joformal për Transparencën dhe Përgjegjësinë në Kuvendi, i cili punon drejtpërdrejt në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në Kuvendi dhe angazhon deputetë, zyrtarë publik, OSHC, organizata ndërkombëtare dhe qytetarë në këtë proces. Kështu, kjo pasqyrohet pozitivisht në rezultatin që merr Kosova në lidhje me treguesin e Qasjes.

NDËRGJEGJËSIMI (75%)

Sa i përket komponentit të Ndërgjegjësimit, Kuvendii Kosovës shënoi 75%. Për shkak të arritjeve të rëndësishme të shënuara vetëm brenda një viti në lidhje me parimin e ndërgjegjësimit, u arrit një rezultat i tillë i kënaqshëm. Sa i përket planifikimit strategjik, me qëllim që të sigurohet një vlerësim i hollësishëm dhe sistematik indikimeve të mundshme të një rregulloreje të re në mënyrë që të vlerësojë plotësimin dhe arritjen e objektivave të dëshiruara të rregullores, Kuvendi i Kosovës nuk u përgjigj. Meqenëse nuk ekzistojnë mekanizma të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), Kuvendi nuk mund të japë një përgjigje në lidhje me këtë kategori specifike. Kështu, Kuvendi shënoi 0% në këtë tregues specifik, i cili siguroi një rezultat prej 75% sa i përket komponentëstë Ndërgjegjësimit.

Në anën tjetër, në nënsektorin e monitorimit parlamentar, Kosova ka shënuar 100%. Një rezultat i tillë tregon një rezultat më të lartë të përgjithshëm në komponentën e Ndërgjegjësimit. Si pjesë e këtij nënsektori, aktivitetet parlamentare dhe dëgjimet regjistruohen në shumicën e rasteve, janë të hapura për publikun dhe të arkivuara. Për sa i përket procedurave parlamentare, përfaqësuesit e Kryesisë Ekzekutive mund

të sillen në Kuvend për t'u përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Gjithashtu, ekziston një procedurë për zhvillimin e një Mocioni të Mosbesimit. Një grup parlamentar ose deputetësh gjithashtu mund të paraqesin një peticion për interpelancë për të shqyrtuar një çështje që lidhet me punën e qeverisë ose të një ministrie.

Për më tepër, sipas nenit 66 si pjesë e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, komisionet kanë të drejtë të konsultohen me ekspertë për qëllimin e marrjes së informacionit mbi një temë që diskutohet. Seancat dëgjimore publike mund të mbahen prej tyre dhe madje mund të futen në diskutim të përgjithshëm me personat që japin informacion për aq sa është e nevojshme për të sqaruar faktet. E gjithë kjo mundëson që qytetarët të informohen me të gjitha ndryshimet që ndikojnë ose mund të ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Kjo përmbush kërkesat e parimit të ndërgjegjësimit dhe kështu e vendos Kosovën edhe më lart në këtë renditje.

INTEGRITETI (96%)

Komponenti i Integritetit përfaqëson një mekanizëm për parandalimin e korrupsionit, rregulloret e lobimit dhe zbatimin e kodit të etikës. Kuvendi i Kosovës ka shënuar gjithsej 96% në këtë komponent.

Kodi i Etikës për Anëtarët e Kuvendit është një mjet efektiv drejt parandalimit dhe zbutjes së korrupsionit në Kosovë. Një Kod i tillë është aneksuar në Rregulloren e Punës, e cila është botuar në faqet e internetit dhe rregullon çështjet e përdorimit të pronës shtetërore, dhuratave, konfliktit të interesit dhe veprimtarisë politike. Zyra e Kryetarit të Kuvendit pranon deklaratën me shkrim brenda (30) ditëve nga seanca inauguruese e Kuvendit, prandaj ajo duhet të përditësohet brenda (30) ditëve nga çdo ndryshim material i cili ndodh. Informatat mbi asetet, burimet e të ardhurave, shumën e të ardhurave dhe detyrimet sigurohen nga lista e asetëve të anëtarëve të kuvendit . Të dhëna të tilla janë të organizuara dhe të strukturuar në një mënyrë lehtësisht të arritshme për publikun. Edhe pse qasja në të dhëna që kanë të bëjnë me deklarinimin e pasurisë nuk është publikuar, një qasje e tillë u sigurohet qytetarëve me anë të kërkesës, pasi ajo jepet në përputhje me Ligjin për Qasjen në Dokumente Publike dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia Kundër Korrupsionit është organi kompetent për monitorimin e zbatimit të listave të aseteve. Agjencia do të paraqesë një kallëzim penal në prokurorinë kompetente, në rast se një deputet shkel detyrimet e parashikuara me ligj. Një raport i tillë penal do të shkruhet kundër zyrtarit të lartë publik që shkel detyrimet duke konsideruar se shkelja përfshin një vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Nëndomeni i tretë si pjesë e komponentës së Integritetit është pjesa e Lobimit. Lobimi është komunikimi me zyrtarë publikë, vendimmarrës politik ose përfaqësues, qoftë ai direkt ose indirekt, në mënyrë që të ndikohet në vendimmarrjen publike dhe zakonisht kryhet nga ose në emër të një klienti ose ndonjë grupi të organizuar. Më konkretisht, në Kosovë nuk ka rregullore për rregullat e lobimit. Në vitet e fundit, lobimi është bërë një fushë e rregullimi në rritje, që ka prioritet kuptimin se kush në veçanti lobon. Nëse të gjitha veprimtaritë e lobimit bëhen publike dhe mbrojtja i jep përparësi interesit publik, rregullat e tilla të lobimit kanë vlera të mëdha.

TRANSPARENCA (88%)

Parimi i transparencës kërkon që informacioni organizativ, buxheti dhe proceset e prokurimit publik të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikuara në faqen zyrtare të internet. Kuvendi i Kosovës ka shënuar një total prej 88% mbi parimin e Transparencës, gjë që tregon rritje krahasuar me rezultatet e vitit të kaluar. Në nëndomenin e informacionit organizativ, Kuvendi i Kosovës shënoi gjithsej 84%. Nëndomeni i informacionit organizativ zgjedh cilësinë dhe sasinë e informacionit në lidhje me funksionimin efektiv të Kuvendit. “Kuvendi i Kosovës është nënshkruar i deklaratës së Hapjes së Kuvendit dhe ka zbatuar planin e veprimit për një kuvend të hapur dhe transparent deri në vitin 2020³. Në përputhje me deklaratën, Kuvendi ka zhvilluar strategjinë për informim dhe Komunikim në kuvend (2019-2021)⁴. Një nga dokumentet më të rëndësishme që Kuvendi ka miratuar është rregullorja për

³ http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2020_06_23_VendimidheRregullorjaperrrendindheqasjenemediavedhetepublikutnepuneneKuvendit_CeARNKtVc4.pdf

komunikim me media dhe publikun në punën e kuvendit, e cila ka vendosur rregulla dhe procedura për stafin, si dhe palët e treta që ndjekin punën e kuvendit për të siguruar komunikimin.”

Faqja zyrtare e internetit e Kuvendit ofron qasje të lehtë në ligje, ndryshime, projekt legjisacion, rregullore, strategji dhe raporte të punës. Një tipar tjetër që kontribuon në transparencën e Kuvendit është Sistemi për Përcjellje të Legjisacionit cili u mundëson qytetarëve të përfshihen më shumë në procesin legjislativ pasi ata mund të përcjellin se në cilën fazë është ligji. Të dhënat e votimit nga seancat plenare të Kuvendit publikohen gjithashtu në faqen e internetit. Për më tepër, Kuvendi ka transmetim në video të seancave plenare, të cilat në tërësi inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin legjislativ, duke forcuar kështu rolin e Parlamentit si institucion. Krahasuar me vitet e mëparshme, Kuvendi i Kosovës po bën gjithashtu përparim në transparencë në lidhje me prokurimin publik duke shënuar tani një total prej 93% në këtë nëndomen. Qytetarët mund të qasen në kontratat për procedurat e prokurimit publik, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit, si dhe në rezultatet e ofertave kryesore të prokurimit publik. Siç është plotësuar edhe në sondazhin e dërguar zyrtarëve të Kuvendit, të gjitha ofertat kryesore të prokurimit publik (përfshirë njoftimin dhe procesin) publikohen përmes portalit shtetëror për prokurimin publik⁵ siç parashikohet edhe me ligj. Megjithatë, ka vend për përmirësim pasi thirrjet për procedurat e prokurimit publik nuk janë ende në dispozicion të publikut. Sidoqoftë, Kuvendi i Kosovës ka publikuar me sukses planin përfundimtar të prokurimit, i cili mund të jetë i qasshëm nga qytetarët e Kosovës⁶.

Kuvendi filloi të publikojë raporte më të hollësishme financiare mbi baza tremujore dhe vjetore në lidhje me shpenzimet e tij. Të dhënat janë siguruar formatin .xls i cili është shumë i lehtë për përdorim dhe i qasshëm nga qytetarët e Kosovës. Kjo është një arritje e rëndësishme që nga gjetjet e vitit të kaluar dhe tregon gatishmërinë e Kosovës për të bërë ndryshime të shpejta dhe efektive për progresin në infrastrukturë dhe në informacionin e dhënë për publikun. Në fund, një rekomandim i cili është adresuar gjatë matjes së vitit të kaluar dhe është ende i vlefshëm është botimi i të ashtuquajturit buxhet i qytetarit, në mënyrë që të rritet transparenca e Kuvendit në komponentën e Buxhetit të Shtetit. Një buxhet i tillë rekomandohet të botohet në një format të lehtë për përdorim dhe të kuptueshëm për qytetarët e zakonshëm, në mënyrë që të rritet transparenca fiskale.

4 [http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2019_02_08_StrategjiaperinformimdhekomunikimeKuvenditteRepublikesseKosoves%27\(1\)_BH2KECcKL.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2019_02_08_StrategjiaperinformimdhekomunikimeKuvenditteRepublikesseKosoves%27(1)_BH2KECcKL.pdf)

5 <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>

6 <http://www.kuvendikosoves.org/shq/raporte/prokurim/>

Angazhimi i Qytetarëve në Punën e Parlamentit në Kosovë

ODK në bashkëpunim me UBO Consulting ka bërë hulumtime në terren për të sjellë në perspektivë pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kosovës për punën e Kuvendit të Kosovës. Si pjesë e kësaj matjeje, gjithsej 1065 qytetarë të Republikës së Kosovës të zgjedhur në mënyrë gjithëpërfshirëse nga të gjitha grupet etnike, moshat, prejardhjet socio-ekonomike, gjinitë dhe vendbanimet kanë marrë pjesë. Nga ky sondazh janë nxjerrë gjetje interesante që do të përdoren si praktika të mira për zbatimin e mëtejshëm të projektit. Sa i përket sondazhit, vetëm 6.1% e të anketuarve shpesh ndjekin punën e Kuvendit të Kosovës. Rreth 35% e të anketuarve ndjekin punën e Kuvendit ndonjëherë, 37% rrallë e ndjekin atë, dhe rreth 22% e të anketuarve kurrë nuk e bëjnë këtë. Gjetjet e tilla lënë hapësirë për të menduar në lidhje me punën e Kuvendit të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës. Këto gjetje mund të nënkuptojnë se qytetarët nuk janë të interesuar të informohen më shumë për punën e Kuvendit të Kosovës, ose se puna e Kuvendit nuk arrin të sigurohet në një format të kuptueshëm dhe të arritshëm. Në të dy situatat ndikohet elementi i hapjes, sepse që një parlament të jetë i hapur dhe transparent, përveç punës së parlamentit, po aq e rëndësishme është shtytja nga qytetarët.

Pyetja vijuese e cila u adresua ishte kënaqësia e të anketuarve, përkatësisht, e qytetarëve të Kosovës me punën e Kuvendit të Kosovës. Vetëm rreth 1% e të anketuarve janë shumë të kënaqur me punën e parlamentit, ndërsa, rreth 23% e të anketuarve janë pjesërisht të kënaqur me punën e parlamentit. Kjo pastaj la rreth 33% të të anketuarve të ndiheshin neutralë për punën e parlamentit, dhe së fundmi rreth 17% janë të pakënaqur me punën e Kuvendit të Kosovës. Pyetja e fundit e ngritur ishte nëse të anketuarit mendojnë se mund të kontribuojnë në iniciativat e ndërmarra nga Kuvendit i Kosovës, ku rreth 27% e të anketuarve menduan se kanë çfarë të thonë dhe se mund të kontribuojnë në nismat e ndërmarra nga parlamenti i Kosovës. Rreth 52% u përgjigjën se nuk mendojnë se mund të kontribuojnë në iniciativat e Kuvendit të Kosovës, dhe rreth 21% e të anketuarve nuk shprehën mendimet e tyre në këtë drejtim. Është shumë e rëndësishme të përfshihen bindjet dhe pikëpamjet e qytetarëve në rekomandimet edokumenteve të propozimit të politikave dhe si të tilla, njëkohësisht gjetjet tregojnë se shumë pak qytetarë janë të angazhuar, e aq më pak të interesuar, për të kontribuar në punën e këtyre institucioneve. Mungesa e gatishmërisë së qytetarëve për t'u angazhuar është gjithashtu një çështje më vete.

REKOMANDIME

HAPAT E VEPRIMIT

Në mënyrë që të rritet rezultati i tij i përgjithshëm, ne rekomandojmë që Kuvendi i Kosovës të ndër marrë hapat e mëposhtëm:

Të kalojë legjislacionin e nënshkrimit elektronik (e-signature);

Të fillojë zbatimin e sistemit të peticionit elektronik (e-petitioning);

Të zbatojë mekanizma të vlerësimit të ndikimit rregulator (RIA) në mënyrë që të sigurojë një vlerësim të hollësishëm dhe sistematik të ndikimeve të mundshme të një rregulloreje të re për të vlerësuar më pas plotësimin dhe arritjen e objektivave të dëshiruar të rregullores;

Të avancojë rregullimin e rregullave të lobimit;

Të publikojë të ashtuquajturin buxhet të qytetarëve, në mënyrë që të rritet transparenca e Parlamentit në komponentën e Buxhetit të Shtetit;

Të organizojë më shumë trajnime për stafin e Kuvendit në fushën e qasjes në dokumente publike;

Të zgjedhë Komisionarin për Informim dhe Privatësi për Agjencinë përkatëse;

OPEN DATA KOSOVO

Ganimete Tërbeshi, 26A, Aktash, Prishtinë 10000

Tel: +383 (0) 49 962 656

Available for calls: 08:00 – 16:00

Email: info@opendatakosovo.org

www.opendatakosovo.org